



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:202331
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05762444

A.C.nr.9128/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi kryetar, Enes Mehmeti dhe Hysni Bardheci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses B.P. nga fshati L..., Komuna Obiliq, të cilën e përfaqëson F.H., avokate, me seli në Komuna Prishtinë, kundër të paditurës Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK), me seli në Komuna Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Majlinda Sadikaj, në çështjen kontestimore për kompensim të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarës së të paditurës të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1706/15 datë 14.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK), me seli në Komuna Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1706/15 datë 14.01.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.1706/15 datë 14.01.2021, ndër të tjera ka vendosur si vijon :

“... I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses B.P. nga fshati L..., Komuna Obiliq, DETYROHET e paditura Qendra Klinike Universitare e Kosovës QKUK, në Prishtinë, që paditëses në emër të kompensimi të dëmit jo material, për shkak të humbjes se mostrës se biopsisë, ti paguaj shumën e specifikuar si me poshtë:

Për demin jo material

Në emër kompensimit për dhimbje shpirtërore të përjetuar frikës, si dhe frikës në të ardhmen shumë prej 5.000 Euro.

II. REFUZOHET pjesa e kërkesëpadisë përtej shumës së gjykuar dhe atë në emër të kompensimit për dhimbjen e përjetuar shpirtërore, friken si dhe friken në të ardhmen shuma prej 4.200 Euro, si dhe kërkesa në emër të kompensimit për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shumë prej 750, Euro, SI E PA BAZUAR.

III. DETYROHET e paditura Qendra Klinike Universitare e Kosovës, në Prishtinë, që paditëses B.P., ti paguaj edhe kamatën vjetore prej 8%, për pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë duke filluar nga data 14.01.2021, (dita e marrjes së aktgjykimit) e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 578 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcenim të përmbarrimit ligjor...”.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura QKUK, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që ta aprovojë ankesën dhe ta ndryshojë aktgjykimin ashtu që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses, ose ta prishë aktgjykimin dhe ta kthej në rigjykim.

Përgjigje në ankesë është paraqitur.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se :

- Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja B.P. nga fshati L..., Komuna Obiliq, të cilën e përfaqëson F.H., avokate, me seli në Komuna Prishtinë, me datë 23.07.2015, ka parashtruar padi kundër të paditurës Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK), me seli në Komuna Prishtinë, për kompensimin e dëmit.

Gjykata e shkallës së parë, pasi ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me datë 14.01.2021, dhe pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse, me Aktgjykimin C.nr.1706/15 datë 14.01.2021, e ka miratuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur me shumë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ndër të tjera e ka arsyetuar se “...Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të

plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruara provat: fleteleshimin në numër 1528, të datës 02.03.2015, përgjigjen në ankese me numër RF.NO 10/SH-036-15 me numër të protokollit. 10 052044 e datës 25.02.2015, raportin nga konsulta të datës 04.05.2015, deklaratën me numër të protokollit. 79, të datës 06.05.2015, vendimin me numër të protokollit. 1600 i datës 26.05.2015, dhe ekspertizën e datës 16.11.2020... Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi qe: Me provat e administruara gjykata ka gjetur se paditësja me datë 02.03.2015, ju ka nënshtruar operimit ne gjirin e majte për marrjen e mostrës se biopsisë, në Klinikën e Kirurgjisë Abdominale në Prishtinë në QKUK. Dhe se pas marrjes se mostrës se biopsisë paditësja nuk është njoftuar për rezultat, dhe meqenëse nuk ka pranuar ndonjë rezultat nga QKUK, më datë 16.04.2015, me ankesë ju ka drejtuar Inspektoratit shëndetësor, për mos marrje të rezultatit të analizës se biopsisë. ...Po ashtu gjykata gjeti se më datë 25.05.2015, Inspektorati Shëndetësor i Kosovës, ju ka përgjigj në ankese paditëses duke e informuar se pas marrjes se ankesës Inspektorati i Shëndetësisë ka bërë inspektimin specifik të Klinikës se Kirurgjisë Abdominale, dhe Institutit të Anatomisë Patologjisë QKUK, në Prishtinë, dhe bazuar në dokumentacionin e mbledhur është konstatuar se paditëses B.P. i është humbur mostra e biopsisë.. Deri të kjo gjendje faktike gjykata ka ardhur duke u mbështetur në këto prova të cilat i ka pranuar si të besueshme dhe atë: fletë lëshimin e spitalit të datës 02.03.2015, përgjigjen në ankese në nr. Ref/ No.10/ Sh-036-151. Kjo gjendje e vërtetuar faktike nuk ka qenë kontestuese në mes të palëve ndërgjyqësore sepse vete e paditura përmes përgjigjes në ankesë e ka konstatuar se paditëses i është humbur mostra e biopsisë, andaj nga kjo rrjedh baza juridike e kërkesëpadisë për kompensim të dëmit... Gjykata vlerësoi se e paditura me humbjen e mostrës se biopsisë i ka shkaktuar dem palës paditëse prandaj konform dispozitave nga neni 136, i Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore, e paditura gjendet përgjegjëse për ti kompensuar dëmin paditëses...”.

Vlerësimet juridike të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullta dhe të bazuara në ligj i aprovon edhe kjo gjykatë, sepse aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e shkallës së parë në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, pasi që edhe për të paditurën nuk ka qenë kontestuese se paditëses i është humbur mostra e biopsisë kjo konstatohet edhe në vendimin e komisionit disiplinor të qendrës Klinike Universitare të Kosovës Ref.nr.285/15 datë 26.05.2015 në të cilin vendim ndër të tjera thuhet se “...materiali (Biopsia) e pacientes B.P., me numrin e Historisë së pacientit 1528, me datën e lartëtheksuar është humbur...”, andaj nga kjo rrjedh baza juridike e kërkesëpadisë për kompensim të dëmit, andaj Gjykata e Apelit vlerëson se gjendja faktike në këtë çështje

juridike është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, dhe për të cilat arsye aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, ka vendosur drejtë, pasi paditëses i takon e drejta në kompensim të dëmit jo material, duke u bazuar në dispozitat e nenit 183.1, 177.1, 172.1, dhe nenit 136.1 të Ligjit nr.4/L-077 për Marrëdhëniet të Detyrimeve, si dhe nenit 323 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, andaj shumat e gjykuara si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar për paditësen B.P., për dëmin jo material, për shkak të dhimbjes shpirtërore të përjetuar, frikës si dhe frikës në të ardhmen shumë prej 5,000 euro, kjo shumë e gjykuar është reale duke u bazuar në mendimin e ekspertes Dr. N.H., psikiatër, e cila eksperte mjekësor për paditësen, ka dhënë mendim se paditësja B.P. gjatë periudhës 24.02.2015 deri me datë 18.05.2015 ka manifestuar simptomatologji të përzier të ankthit dhe depresionit Dg. Çrregullim anksiozo depresiv (ICD-10) – ankth me intensitet mjaftë të lartë, i cili ankth paraqitet herë pas here edhe pas asaj periudhe tre mujore por me intensitet më të ulur sidomos në situata kur përmendet biopsia, disponim të ulur, çrregullim i gjumit, humbje e interesimit për veten dhe rrethin, rënie e përqendrimit, rënie e oreksit si dhe simptomë vegetative si dridhje, marrëmendje, kokëdhembje, palpitacione, e duke marrë parasysh këtë vlerësim mjekësor, dhe praktiken gjyqësore shuma e gjykuar është e drejtë.

Në nenin 183 par.1 të Ligjit nr.4/L-077 për Marrëdhëniet të Detyrimeve ndër të tjera thuhet se *“Për dhembjet ..., për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material...”*.

Të pathemeltë Gjykata e Apelit i vlerëson edhe pretendimet ankimore të palës ankuese për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase kjo gjykatë me shikim në shkresë të lëndës ka konstatuar se në bazë të provave të nxjerra gjatë shqyrtimit kryesor gjendja faktike del të jetë hetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, e cila ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse, juridike dhe faktike lidhur me faktet vendimtare të cilat kanë pas ndikim në mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar, të cilat si të rregullta dhe të bazuara në ligj në tërësi i pranon edhe gjykata ankimore.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë çështje drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore dhe kështu Gjykata e kishte një pasqyrë reale mbi gjendjen faktike në këtë çështje juridike, për këto arsye aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se sa i përket pretendimit ankimor të palës së paditur se kemi të bëjmë me aplikim të gabuar të së drejtës materiale nuk ka ndonjë pretendim konkret në të cilën është thirrur pala ankuese në ankesë.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të të paditurës, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, e në pajtim me nenin 195 paragrafi 1, pika (d), e lidhur me nenin 200 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.9128/2021 datë 22.05.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari,
Bujar Muzaqi